

LAURA SMAQI

**LASGUSH PORADECI DHE MARRËDHËNIET KULTURORE
SHQIPTARO-RUMUNE**

Një ndër rastet më fatlume, në mos më fatlumi për sa i takon marrëdhënieve në fushën e letërsisë dhe kulturës mes vendeve të Evropës Juglindore është ai i Shqipërisë dhe Rumanisë, në mënyrë të veçantë prej shek. XIX e më pas. Vetë Lasgush Poradeci do të hartonte një historik të përmbledhur të gjithë veprimtarisë së shqiptarëve në Rumani *Vepërimi kombëtar i shqiptarëve të Rumanisë me kryeqendër kolloninë e Bukureshtit*¹, si ish sekretar i saj, duke theksuar faktet e njohura mbi rëndësinë e kësaj kolonie, në aspektin historik dhe kulturor, si mjedisi ku u botuan vepra të rëndësishme (veprat e N. Frashërit që prej 1886-1898), si vendi ku jetuan një pjesë të jetës dhe ku botuan Asdreni, Lasgushi, Kuteli.

Mbi marrëdhëniet shqiptaro-rumune ka studime të periudhave të ndryshme, një tjetër figurë e rëndësishme e lidhur mjaft me mjedisin rumun, Kuteli, është marrë me përkthime, me shkrime të përgjithshme mbi autorë rumunë si dhe me vënien në dukje të lidhjeve të krijimtarisë së Lasgushit me poezinë rumune.

Në shkrimin AUTOKRITIKË – *mbi shqipërimin e disa vjershave të Mihail Eminescu-t*, botuar në “Shënime letrare” 1944, bën me dije se “*Lasgush Poradeci e ka njohur e shijuar veprën e poetit rumun që në të ri, kur quhej thjeshtazi Llazas S. Gusho, nga Poradeci, edhe ndiqte, si nxënës, Liceun Rumun te Manastirit. Që asokohe vazhdoi ta thellojë gjithmonë, dyke e zgjedhur më 1931, si u largua nga sanskritishtja, për theme laure – thezën e doktoratit – të kaluar në Universitetin e Graz-it.*”² Gjithashtu në “Shënime letrare”, në shkrimin “Disa fjalë mbi vjershat e reja të Lasgushit” bën me dije: “*...kemi filluar të bëjmë një studim përmbi lidhjet e poetit tonë me kulturën rumune dhe kontigjentet e saj në veprën e Lasgushit. Kur shkruajmë këto e kemi veçanërisht mëndjen në pastelisti Vasile Alecsandri, ne idilisti Gheorge Cosbuc (Koshbuk) e sidomos ne*

¹ L. Poradeci, *Vepra 2*, Onufri, Tiranë, 1999.

² M. Kuteli, *Shënime letrare*, GrandPrind, Tiranë, 2007, f. 274.

*vigani Mihail Eminescu.*³ Kuteli është gjithashtu i pari që ka vënë në dukje se Lasgushi “ka farkuar një pjesë të fjalorit të vet nënë rrymën tiranike” të Emineskut dhe thekson ndërtimin *dhembshurisht e ëmbël / dureros de dulce*; dhe kuptimet poetike të fjalës *magji / farmec*.

Ndër studimet e mëpasme përmendim më të rëndësishmet: Në vitet '60, Vehbi Bala ka trajtuar marrëdhëniet kulturore shqiptaro-romune, marrëdhëniet mes krijimtarive popullore dhe ato të letërsisë mes dy vendeve. Në studimin “*Lidhjet letrare shqiptaro-romune*”⁴, nisur nga ideja që në ngjizjen e letërsisë shqipe, përveç letërsisë sonë të vjetër dhe krijimtarisë popullore, rol të rëndësishëm kanë luajtur dhe letërsitë e disa vendeve ballkanike e më gjerë, ndalet në faktin e ndikimit të disa prej shkrimtarëve të letërsisë shqipe, prej letërsisë rumune. Krah argumentimit të tezës së tij, se të përbashkëtat historike dhe ngjashmëria apo të përbashkëtat e krijimtarisë popullore kanë luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në praninë e të përbashkëtave letrare, Bala flet për dy mënyra ndikimi: ndikim të drejtpërdrejtë rumuno-shqiptar dhe përmes kulturave të tjera, përkatësisht asaj gjermane, në rastin e Lasgushit, të cilin e sheh me autorët rumunë më të ngjashëm me të. Ndikimi i përbashkët gjerman çonte në ngjashmëri mes autorëve shqiptarë dhe rumunë.

Ndër elementet që përqasen përmendim poezitë “*Naim Frashëri*” të Lasgushit dhe poezitë *Letra e tretë* dhe *Epigonët* të Emineskut. Elementi – simbol *Yll* tek të dy poetët dhe malli, që i mban yjtë në lëvizje të përjetshme e u jep forcë ndriçimi. Vihet në dukje prania e përsëritjeve (*Ata ikin varg e varg... Aty vin... e gjithë vin... - Lasg.*) të Eminesku (*Gjithë venë, venë gjithnjë...*).

Ndonëse prania e liqenit në poezinë e Poradecit është e kuptueshme prej lidhjes së ngushtë me Pogradecin, Bala vëren, të paktën nga ana e ndërtimit teknik dhe figurative, lidhje me figurën e liqenit të Emineskut. Të tjera ide dhe motive shtjellohen në poezitë “*Dremit liqeri*” dhe “*Lacul*”, por nga ana e ndërtimit është e pranishme jehona e poezisë së Emineskut. “*Kemi të njejtin metër, të njejtën skemë rimash, të njejtën kadencë ritmike*”. Të përbashkëta janë dhe figura e Pezullimit, thirrja me O etj. Bala është i mendimit që ndikimi prej Emineskut u realizua edhe përmes poetit pasardhës të tij (Emineskut), Koshbukut prej të cilit Lasgushi u ndikua si në mjete stilistike dhe metrike. Këto elemente thotë Bala, Lasgushi i mori si drejtpërdrejt nga Eminesku, ashtu edhe nga Koshbuku.

³ *Po aty*, f. 278-9.

⁴ V. Bala, *Lidhjet letrare shqiptaro-romune*, Buletin shkencor i Institutit pedagogjik, Shkodër, 1965.

Vihet në dukje roli i teozofisë tek Lasgushi, pjesë dhe e ndikimit të poezisë dekadente rumune dhe artit për art, që duke u lidhur me teozofinë përbën fondin e filozofisë dhe të “manierizmit” lasgushian. Ky ndikim sipas tij lidhet dhe me ndikimin që la Lasgushi me poezinë gjermane, si drejtpërdrejt ashtu edhe përmes poezisë rumune.

Sipas Balës ndikimi i poetëve rumunë tek Lasgushi që më shumë në “*çështje të formës, në procedimin stilistik figurativ dhe teknik, në metrikën dhe prozodinë*”.

U ndalëm më gjerësisht në tezat e V. Balës, pasi ato janë të pranishme dhe në studimet e mëvonshme, që venë në fokus lidhjen e poezisë së Lasgushit me atë të Emineskut.

Në 1980, Rexhep Ismajli, brenda përmbledhjes studimore “*Shumësia e tekstit*”⁵, trajtoi dhe aspekte të këtyre marrëdhënieve. Ai i vendos në rrafsh krahasues termat MALL dhe DOR, duke bërë sprovën e parë krahasuese mes tyre, nisur nga poezia.

Në botimin e vitit 1990 “*Don Kishoti zbret në Shqipëri*”⁶, Aurel Plasari i kushton dy studime të përbashkëtave e ndikimeve mes dy letërsive. Së pari në vështrimin krahasues “*Malli në poezinë shqiptare, romune etj.*”, duke u nisur nga afritë semantike të termave MALL dhe DOR dhe ndjenjave që ato shprehin në gjuhët respektive, përveç trajtimit të përgjithshëm teorik, ai përqas Lasgushin me Emineskun, në aspektin e të përbashkëtave në poetizimin e ndjenjës. Më pas në studimin “*Princ përballë princërve*”, përqas shkurtimisht Poradecin sërish me Emineskun, porë në të tjera aspekte.

Në monografinë “*Vetmia nostalgjike në poezi (Vështrim krahasues për lirikën shqiptare dhe rumune)*”⁷, Luan Topçiu trajton gjerësisht mënyrën sesi kjo ndjenjë universale e në mënyrë të veçantë **malli** dhe **dori** është trajtuar poetikisht në letërsitë shqiptare dhe rumune. Zgjerimi i fushës semantike të fjalës **mall** me asociacione që nuk ekzistonin më parë në poezinë shqipe, u bë i mundur sipas autorit falë njohjes dhe realizimeve poetike të pranishme në mjedisin kulturor rumun. Është një studim i gjerë, mbështetur si në poezinë popullore dhe në krijimtarinë e poetëve të dy vendeve, duke theksuar faktin që autorët e analizuar “janë bërë

⁵R. Ismajli, *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë, 1977.

⁶ A. Plasari, *Don Kishoti zbret në Shqipëri dhe ese të tjera të letërsisë së krahasuar*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.

⁷ L. Topçiu, *Vetmia nostalgjike në poezi (Vështrim krahasues për lirikën shqiptare dhe rumune)*, Omsca-1, Tiranë, 2005.

transmetues të një tipi të ri ndjeshmërie, të një vizioni për jetën me domethënie kombëtare dhe rajonale (ballkanike).’’⁸

Ndër autorët e përmendur, Bala dhe Topçiu e theksojnë ndikimin rumun tek Lasgushi, Ismajli, në ndonjë rast flet për mbështetje në traditat e mëparshme të letërsisë shqipe, në ato aspekte që dy studiuesit e përmendur flasin për ndikim. Plasari qëndron mes dy skajeve, por diçka më pranë Ismajlit se autorët e tjerë. Duket sikur në periudhën e fundit të viteve ’70 e viteve ’80, ka qenë më e pranishme tendenca që të gjendet burimi i parë i krijimeve letrare brenda letërsisë shqipe, duke kufizuar çështjen e ndikimeve.

Siç shihet, çështjet e paraleleve, të përbashkëtave mes poezive të Lasgushit e Emineskut dhe rolit të këtij të fundit në aspekte të veçanta të krijimtarisë së poetit shqiptar, janë trajtuar në rrjedhë të kohës. Ndryshe ka ndodhur me punimin e Lasgushit për Emineskun, punim doktrate, i mbrojtur në Grac në vitin 1933, botuar në Shqipëri⁹ në vitin 2009¹⁰. Ndonëse është përmendur shpesh në studimet dhe shkrimet mbi Lasgushin, për të treguar lidhjen e tij shpirtërore me Emineskun, fakti i të qenit në gjuhë të huaj dhe i pabotuar, kufizonte mjaft njohjen. Njohja e punimit na njeh me faktin që mjaft teza të hedhura mbi lidhjet e letërsisë rumune dhe asaj shqiptare, mbi DOR-in rumun, mbi lidhjet mes poezisë së Lasgushit dhe asaj të Emineskut, apo elemente të krahasimeve që u janë bërë dy poetëve nga studiuesit e përmendur, janë trajtuar me mjaft seriozitet prej vetë Lasgushit që në vitin 1933. Si strukturë punimi është ndërtuar me Parathënien, Hyrjen, 6 kapituj dhe Përfundime e Bibliografi.

Në parathënie të punimit, Lasgushi thotë se ndryshe nga studimet e kryera mbi marrëdhëniet rumuno-franceze dhe rumuno-italiane, studimet mbi marrëdhëniet rumuno-gjermane mbeten detyrë e së ardhmes. Për të ndihmuar në këtë njohje ai mundohet që përmes punimit të doktoratës të japë ndihmesën e tij.

Në Hyrje, autori ndalet mbi ndikimet më të ndjeshme të kulturave të huaja në lindjen e kulturës kombëtare rumune. Ndikimi francez përmes revolucionit e ideve të tij të mëdha luajti rol në forcimin e ndërgjegjes kombëtare. Por, sipas Lasgushit krahas ndikimit francez, dhe ai gjerman ka

⁸ *Po aty*, f. 258.

⁹ Së pari në shqip, vepra është botuar në Prishtinë, me përkthim të Arif Kutleshit, më 2003.

¹⁰ L. Poradeci, Ll., Gusho, *Eminescu i injoruar dhe ideologjia e tij popullore - atdhetare (Studimjenetik duke pasur parasysh lidhjet me kulturën gjermane)*, Argeta-LMG, Tiranë, 2009. (Përkthyer nga Kiço Bendo dhe Perikli Jorgoni.)

qenë i pranishëm përmes udhëheqësve të lëvizjes kombëtare rumune që studiuan në Gjermani.

Dy janë aspektet në të cilat Lasgushi e sheh ndikimin gjerman tek Eminesku:

1- Së pari në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes paraleleve me autorë dhe filozofë gjermanë.

2- Përmes rolit që ky ndikim luan në formimin e vetëdijes atdhetare të Emineskut. Mbështetja në folklor e pikëpamjet politike të Emineskut lidhen me këtë linjë.

Kontribut mjaft interesant është kapitulli i parë, ku përqasen dy poezi: poezia *Ylli*, e Emineskut dhe *Në kaltërsi yllin a e sheh* e Kellerit. Çështja kryesore lidhet me pyetjen nëse poezia e Emineskut është përkthim, imitim, krijim spontan? Ndonëse në pamje të parë duket si përkthim, në të vërtetë ky rast paraqitet më kompleks. Lasgushi ve në dukje se tek riprodhimi i Emineskut dallohet shtimi i një strofe (përkatësisht strofës së tretë), e cila në një përkthim korrekt jo vetëm që nuk do të ishte e nevojshme, por e tepërt. Mjaft interesant është mendimi i shprehur prej Lasgushit se “*poezia emineskiane është një imitim në momente të gjetura me origjinalitet dhe remineshencë e poezisë së Kellerit*”¹¹. Të përbashkëta janë: motivi i krahasimit, drita e yllit që shfaqet në qiell shumë kohë mbasi ai është shuar si dhe renditja e imazheve, të cilat tek dy poezitë janë thujse fjalë për fjalë të njëjta. Por ndërsa te Kelleri “efekti krahasues” (dashuri-dritë ylli L.S) do të ndodhë në të ardhmen, mbasi të ketë vdekur mikesha e poetit, tek Eminesku ka ndodhur tashmë në të shkuarën. Interpretimi i Lasgushit në të cilin ndërthuren njohja e psikologjisë, filozofisë, konteksteve në të cilat janë shkruar poezitë dhe analiza e përimtuar e teksteve është mbresëlënëse.

Në kapitujt e tjerë ai ndalet në disa nga veprat më të njohura të Emineskut, për të vënë në dukje ideologjinë dhe frymën popullore të krijimeve të tij. Po ashtu ndalet në ndikimin e Nirvanës, të popullarizuar prej Shopenhaurit, ndonëse i kuptuar jo drejt sipas Lasgushit, në ndikimin e kozmogonisë së Rig Vedës nga e cila Eminesku ishte tërësisht i frymëzuar. Vënia në dukje e rolit të autorëve gjermanë në krijimtarinë e Emineskut, nga Gëtja, Hajne, Novalis, Lenau si në frymë ashtu dhe në huazimet leksikore, ndikimet sintaksore, ndërtimet analoge përmes

¹¹ *Po aty*, f. 27.

përkthimit, ndonëse vetëm vihen në dukje, janë aspekte mjaft të rëndësishme që i shërbejnë studimeve më të thelluara, të cilat mund të nisen prej ideve të hedhura nga Lasgushi. Të gjitha paralelet e hedhura, mbështeten nga njohja e biografisë së Emineskut, i cili, siç ve në dukje përmes burimeve dhe Lasgushi, kish marrë që në vogëli njohuri për gjuhën gjermane, të cilën e fliste dhe e shkruante që në moshë të hershme. Mjaft krijime të shkruara drejtpërdrejt gjermanisht janë një tjetër tregues njohjeje.

Aspekti më interesant i studimit të Lasgushit sipas mendimit tim është fakti që ai mund të shërbejë si model për analizimin e vetë krijimtarisë së tij, sidomos në aspektin e problematikës së ndikimeve. Analiza e kujdesshme e tekstit, për të përcaktuar me sa më shumë objektivitet lidhjet mes poezive të Emineskut dhe atyre të autorëve gjermanë, thellimi në të kuptuarin e mbështetjes së krijimtarisë së Emineskut në krijimtarinë popullore, dhe në mënyrë të veçantë vënia në dukje e ndikimit të teozofisë, Rigvedës, janë aspekte që nuk janë thelluar në masën e duhur në studimet mbi Lasgushin. Çështja e ndikimit gjerman tek Lasgushi, si në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu dhe të ndërmjetuar përmes kulturës rumune është një aspekt kyç që mbetet detyrim objektiviteti për studimin e poetit tonë dhe për të bërë të mundshëm studimin e marrëdhënieve shqiptaro-gjermane në poezinë shqipe, në aspekte që vetë Lasgushi trajtoi për sa i takon marrëdhënieve rumuno-gjermane.

Në përfundim do të thoshim se roli që luan krijimtaria e Mihail Emineskut, një prej autorëve më të njohur rumunë, në krijimtarinë dhe punën studimore të një tjetri autor po ashtu madhor, por që i takon letërsisë shqipe të viteve '30, Lasgush Poradecit, është një ndër rastet kur letërsia dhe studimi letrar bëjnë të mundur njohjen dhe evidentimin e vlerave më pozitive letrare të vendeve të ndryshme.